



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1126/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtrri me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri për shkak të falsifikimit të bexhit, për raundin e Dytë për Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**Hudhet** e palejuar ankesa Anr.1126/2021, e datës 14.11.2021, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri për shkak të falsifikimit të bexhit, për raundin e Dytë për Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datë 14.11.2021

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar më datë 14.11.2021 ankesën Anr.1126/2021 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se më datë 14 nëntor 2021 nga ora 7:00 e mëngjesit, Subjekti Politik LDK ka angazhuar në pozitën e vëzhguesit (në Zgjedhjet Lokale për balotazh), kandidatin për Kuvendin e Komunës nga subjekti i tyre politik, Behar Duraku, duke e pajisur me bexh të falsifikuar ë Qendrën e Votimit 2717B në fshatin Stroc në Komunën e Vushtrrisë. Sipas parashtruesit të ankesës me këto veprime janë shkelur Neni 390 i Kodit Penal dhe Neni 36 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur kopjen e një liste me emra të vëzhguesve të Qendrës së Votimit në fjalë.

Në përgjigjen e KQZ-së, të datës 14.11.2021 lidhur me Qendrën e Votimit nr.2717B, në fshatin Stroc, Komuna e Vushtrrisë theksojnë se pas verifikimit nga ZRPPC-ja për të gjithë vëzhguesit e listës së vëzhguesve të akredituar nga KQZ-ja, ju njoftojmë si në vijim: Asnjëri nga tre vëzhguesit e LDK-së nuk janë të akredituar për vëzhgim në raundin e dytë, përpos vëzhguesi Ali Mustafa ka qenë i akredituar për Raundin e pare, ndërsa, vëzhguesit e PDK-së janë të akredituar. Më tutje KQZ-ja thekson se \_vetëm dy vëzhgues nga i njëjti entitet lejohen në të njëjtën kohë në vendvotim e rrjedhimisht nuk do duhej të ishin në hapje të vendvotime nga 3 vëzhgues nga i njëjti subjekt.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, theksohet se kjo ankesë është e paqëndrueshme për faktin se pretendimet e Subjektit Politik PDK nga fotot e bashkangjitura nuk provojnë diçka konkrete edhe as pretendimin e Subjektit Politik se bexhi është i falsifikuar nuk ka fare ndonjë provë lidhur me bexhin, dhe njëherit thekson se ky është një supozim i rrëzueshëm juridik sepse PZAP-i nuk merret me shqyrtimin e çështjeve të vërtetimit ose jo të veprave penale .

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pasi i shqyrtoi shkresat e lendes veç e veç si ankesën e palës ankuese, përgjigjen e LDK-se si dhe përgjigjen e KQZ-se gjeti se ankesa e tille është e palejuar për faktin se personi i cili përmendet se e ka falsifikuar bexhin Behar Duraku nuk ka qene vëzhgues i akredituar nga KQZ-ja për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale të Raundit të Dytë të datës 14.11.2021 dhe nuk është arritur që të vërtetohet se i njëjti ka qenë vëzhgues apo aktivist i Subjektit Politik LDK dhe meqenëse se nuk është arritur që të vërtetohet se i njëjti i përkiste subjektit politik LDK, Paneli konstatoi se ankesa e tille është e palejuar për faktin se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që të shqyrtoj rastet me elemente të veprave penale por se për raste me elemente penale të njëjtat do të dërgoj për kompetence të mëtejme në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës

Ky vendim i PZAP-së, në kuptim të nenit 120 paragrafi 5 të LZP-së, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë, pasi që vendimet e PZAP-së, janë vendime administrative, dhe në asnjë rast nuk e paragjykon çështjen për zhvillimin e një procedure tjetër.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

Anr.1126/2021 më datë 15.11.2021

**Kryesuese e Panelit**

Milena Đerić



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së.